

1. Hapje e bulevardeve të reja për të marrë frymë Tetova
Bulevardi “Vidoe Smilevski Bato” drejt Porojit, bulevardi Blagoja Toska,
bulevardi Ilinden nga posta drejt stadiumit të qytetit

2. Ndërtimi i kapaciteteve të reja për parkim

Katër objekte të reja për “Parkim në kate” në hyrje të qytetit te Vero,
afër Gjyqit, pas restorantit Grand/Arbi dhe afër stadiumit të qytetit

3. Shndërrimi i kazermës në park të qytetit dhe qendër komunitare

Park i qytetit te kazerma me hapësira rekreimi të veçanta për të gjithë,
hapësira për zhvillimin e disiplinave sportive të lëna pas dore si atletikë,
gjimnastikë, tenis, ping-pong, shah e të tjera, kopsht për fëmijë, hapësirë
për akademi sportive për klubet e futbollit si Shkëndija, Renova e Teteksi,
zonë e tifozëve me zyra dhe hapësira shoqëruese. Poashtu do të shqyrtohet
mundësia e vendosjes së disa institucioneve publike në këtë hapësirë të re.

4. Ripianfikimi dhe funksionalizimi i sheshit të qytetit; integrimi me
Kompleksin e Ri dhe Kompleksin e Vjetër

Projekt për ridizajnim të sheshit të qytetit sipas kriterëve bashkëkohore
estetike, urbanistike dhe arkitektonike, me qasje më të lehtë në
komunikacion dhe me vendparkime të reja. Studim për ringjallje të
Kompleksit të Ri dhe Kompleksit të Vjetër, për t’i integruar ato me sheshim
dhe për rritje të qarkullimit ekonomik dhe vlerës së pronave

5. Restaurim i pjesës së vjetër të qytetit

Tetova do të ketë “Lagje të mbrojtur dhe të restauruar” sipas stilit autentik
tetovar në pjesën e vjetër të qytetit, duke rregulluar ambientin, rrugët,
fasadat e të tjera sipas stilit të vjetër autentik tetovar

6. Investime në infrastrukturë në çdo lagje dhe në çdo fshat

Investime në infrastrukturë të re apo riparim gjithkund në komunë në rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik e të tjera.

7. Administratë efikase, transparente dhe e digjitalizuar

Komunë transparente, e digjitalizuar me administratë të zgjedhur me sistem meritokracie dhe e hapur për qytetarë.

8. Investime në kapacitete të reja për pastërti publike dhe gjelbërim

Rritja e kapaciteteve për pastërti dhe parqe të reja urbane në lagje të ndryshme të qytetit.

9. Zhvendosja e burgut të qytetit dhe ridestnimi në hapësirë për fëmijë

Dislokim i burgut jashtë zemrës së qytetit dhe shndërrimi i hapësirës së tij në vend të dedikuar për fëmijë me çerdhe, hapësirë të gjelbërt dhe kënd lojrash për fëmijë

10. Çerdhe të reja; përmirësim i kushteve nëpër shkolla

Do të dyfishohet numri i çerdheve eksistuese. Do të bëhet intervenim te infrastruktura e vjetëruar në secilën shkollë, sipas nevojave specifike të tyre.

11. Modernizim i rrjetit të shpërndarjes së ujit nëpër vendbanime

Riparim i rrjetit ekzistues të shpërndarjes së ujit. Ndërtim i rezervuarëve për ujë të pijshëm për pjesët e sipërme të qytetit dhe fshatrave, studim për furnizim me burime të reja.

12. Investime për zhvillimin e turizmit malor gjatë 12 muajve të vitit

Plan urbanistik për Kodrën e Diellit me rindërtim të teleferikut, investime në pjesët tjera të Malit Sharr për turizëm dhe rekreacion sportiv gjatë 12 muajve.